UDHËZIM
Nr. 22, datë 20.8.2015

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 618, DATË 7.9.2006, "TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË DOKUMENTACIONIT DHE MASËS SË PËRFITIMIT TË PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA", TË NDRYSHUAR

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, të pikës 27 të vendimit nr. 618, datë 7.9.2006, "Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 618, datë 7.9.2006, bëhet 10.030 (dhjetë mijë e tridhjetë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 1 të vendimit. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i personit me aftësi të kufizuar.
2. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 618, datë 7.9.2006, bëhet 10.030 (dhjetë mijë e tridhjetë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2 të vendimit dhe 10.530 (dhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë) lekë në muaj për kujdestarin.
3. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2015 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2015, për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.
4. Udhëzimi nr. 13, datë 29.9.2014, i Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe shtrin efektet nga 1.9.2015.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË
Blendi Klosi